



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR**

---

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al), Tel: +35522400150

**PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN**

**PËR**

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 TË  
BASHKISË SHKODËR”.**

**Konsultim publik:** *Njësia Administrative Guri i Zi*

**Data:** 12.10.2022

**Ora:** 13.00

**Vendi:** *Salla e takimeve Njësia Administrative Guri i Zi.*

**Numri i pjesëmarrësve:** *Numri i pjesëmarrësve 23, nga të cilat 1 femër.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet:** *Per draft projekt planin buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Shkodër*

**Pjesëmarrës:** Drejtues dhe specialist të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi bashkë-drejtohet nga Zv. Kryetari i bashkisë, Kryetari i Njesisë Administrative dhe përfaqësues të Këshillit Bashkiak të cilët bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me:**

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjet që konsultohen janë si vijon:**

Hapja konsultimit nga zv. Kryetari i Bashkisë, fjala përshëndetëse dhe prezantimi i pjesëmarrësve pjesë e stafit të Bashkisë Shkodër në takim.

Fillojmë me rradhe sipas funksioneve tona duke nisur nga :

**Pjerin Marku:** Është një praktikë reale që e kemi ndjekur që 7 vite duke paraqit kërkesat dhe nevojat tona – sa është arrit për tu bërë e dime dhe normal ka gjëra të tjera për të bërë.

Nuk dua të bëjmë takim politik por për 7 vite ne kemi xjerrë 22 deputet në krahun e djathtë dhe të majtë dhe mbijetesa jonë është varur përher vetëm nga të ardhurat tona pa asnjë vemendje nga deputetet – kemi shfrytëzuar vetëm lekët e banorëve duke perfitu edhe nga fondet e bashkise dhe sistemuar ato që kemi mundësi.

Kemi patur përher vëmendje nga bashkia dhe nga menaxhimi që bëjmë ne – e rëndësishme është që të jemi të saktë dhe jo politik sepse skemi pasur asnjë burim financimi për zonën tonë dhe duke vu re interesin e kësaj zone do të kishte qënë shumë e drejtë që të kemi pranin e deputeteve të zonës për të parë më nga afër nevojat që ka territori. Kemi dëgjuar përher premtime nga deputetët e të gjitha partive por nuk është bërë asgjë në vite. Për sa është punuar në vite megjithë nevojat që ka komuniteti është e pamundur ti plotësojmë të gjitha dhe jemi të kënaqur me atë që është arritur deri me tani. Kërkesat tuaja janë të gjitha normalisht prioritet dhe duke qënë se është edhe këshilli bashkiak këtu do të kemi mundësi që edhe nga ana e tyre të kemi mundësinë të realizojmë atë që është e mundur. Ju falenderoj për pjesëmarrjen nga ana e juaj.

**Zv. kryetari Tonin Dedaj** ju përshëndes dhe falenderoj që jeni pjesë e këtij takimi ku të dyja palët do të kemi mundësi të konsultohemi me njëri tjetrin për të kaluar në këshillin bashkiak si prioritet investimesh për zonën. Këto takime janë të rëndësishme sepse arrijmë të evidentojmë direkt nga ju nevojat për investime dhe duke qënë se edhe këshilli bashkiak është pjesë e këtyre takimeve i quaj me shumë rëndësi paraqitjen e këtyre nevojave në mënyrë që edhe këshilli të jetë në korrent që përpara se të shkojnë për miratim buxheti nga këshilli.

Do të zhvillojmë takimin duke paraqitur nevojat sipas fushave të përgjegjësisë që ka bashkia Shkodër dhe problematikat që paraqiten.

### **1- Arsimi baze dhe parashkollor**

**Joze Ndoci** – shkolla Juban ka nevojë për dy tualete të brendshme sepse janë në oborr dhe është e nevojshme të ketë banjo të brendshme – ka klasa të lira të cilat mund të kthehen në banjo.

Gjithashtu prroni që është pranë shkollës futet ne oborrin e shkollës dhe krijon problem.

### **2 - Menaxhimi i mbetjeve**

**Kole Ndrejaj** - Në juban nuk ka rrjet të pastrimit dhe duhet të shtohen pika të grumbullimit

**Zef Kcira** – të shtohen kosha nga karburanti - Guri i zi – Gajtan

**Kole Marku** – Banorë fshati rrencë – është bërë rruga rrenc bardhaj dhe duhet të shtohet ndonjë kosh / pikë grumbullimi për mbetjet

Kërkohet rritje e sipërfaqes së mbulimit.

### **3. Shërbimet në komunitet ndriçim gjelbërim**

Fshati Juban nuk ka as shtylla dhe as ndriçues dhe është i vetmi fshat që ka nevojë për ndriçues dhe shtylla.

**Gjon Pjetri** fshati Rrencë – për ndriçimin në rrencë pranë shkollës ka edhe shtylla por nuk është bërë asgjë mjaftojnë edhe 4 – 5 ndriçues

**Pjerin Marku** – ka një nevojë në rrencë kemi pasur mundësi për ti vendosur dhe teknikisht ka qënë e pamundur – është një zonë uzina Rrenc ku kemi mundësi ti vendosim dhe a është mundësia që në këtë zonë që ka edhe biznese të mëdha me punëtor të vendosim ndriçim publik. Duke qënë se janë biznese duhet të japim ndriçim dhe shërbim për këtë pjesë.

Duhet të prioritarizojmë investimet dhe gjithsesi ti vendosim në buxhetet tona duke para mundësinë për ti realizuar.

Na është premtuar në rragam – **shefqet mucaj** – për ndriçim publik përgjatë rrugës deri tek kisha dhe nuk është bërë akoma.

Është rrjeti i korrentit 6 mijë voltsh i cili ka shumë problem dhe duhet të vijë përfaqësues të OSHEE sepse linja e interkonjeksionit është shumë afër me tokën.

**Kryetari i fshatit Kuç** – kemi ndriçim në fshatin Kuç. Linja kryesore e fshatit ka nevojë për një vemëndje tek shtyllat e linjës kryesore të OSHEE.

**Zv. kryetari** – problematika me OSHEE kemi pasur në çdo dëgjese dhe ne do të bëjmë një përmbledhje në emër të kryetarit të bashkisë për OSHEE.

**Frederik Marku** – Ganjollë ne kemi disa shtylla dhe janë pak duhet shtuar edhe ndonjë ndriçues tjetër

**Zv. kryetari** – me projektin që do të realizojmë në Shkodër për ndriçimin publik do të kemi të mundur që ato ndriçues nga shkodra të sillen në njësi administrative

### **3- Menaxhimi i ujitjes dhe kanaleve kullues**

**Fshati gajtan – Zef Kçira** – është kanali dhe rrjeti vaditës që kalon nga gajtan 2 gajtan 1 – kotaj e deri në rrenc – ky kanal ka qënë shumë i mirë dhe ka nevojë që të ketë mirëmbajtje duke qënë se është egzistues është e mundshme të realizohet.

**Alban Sekja** – kanali i gajtanit është parashikuar të bëhet në dy lote dhe pritet të hidhet në prokurim dhe është i gatshëm për zbatim

**Gjon Ejlli** - Guri I Zi – kanali kullues anës së hekurudhës është i bllokuar.

**Albani Sekja** është e realizueshme

Bistalli dhe Rragami përmbysten tokat çdo vit – na është premtuar por nuk është bërë asnjë punim në këtë zonë.

**Zv. kryetari** – për këto kanale në harte kanë emërtime të tjera dhe nuk janë në kompetencë të bashkisë Shkodër sepse janë pjesë e bordit – megjithatë ne jemi duke ndërhyrë që të realizojmë ndërhyrje.

Me datë 19 kemi një mbledhje në prefekturë me drejtorin e bordit dhe do të përpiqemi ti japim një zgjidhje pavarësisht se nuk janë në kompetencë tonën.

**Kole Ndrejaj** Juban - Jubani nuk ka asnjë rrjet vaditje eficient dhe ka nevojë për pastrim. Të verifikohet.

Tek kanalet e kullimit kemi problem KK I i cili ka nevojë për pastrim pavarësisht se nuk është e jona bashkia ka pastruar KK II KK III dhe ka kriju edhe më tepër problem **Jozef Ndoci Juban**

**Pjerin Marku** – kanali i jubanit funksionon në përqindje të caktuar për ferrat të mos diskutojmë sepse mundemi edhe ne vetë që punojmë ta realizojmë

Ky kanal fillon nga spathari dhe shkon deri në rrencë por është e nevojshme që me një makin të vogël të bëhet pastrimi i mbetjeve që vijnë nga projtë përpara fillimit të sezonit të vaditjes të futet në punë. E kemi pas propozim të vazhdueshëm.

Ujitja e tokave bujqësore nuk është mirë – **Isa Bajrami** – kanali pranë rrugës së Jubanit ka ujë por nuk ujitet – ne duhet të evulojmë dhe të kalojmë në ujitjen me pika dhe duhet filluar kjo gjë.

Ose të vendosen panelet diellore që arrijnë të furnizojnë pompat e ujit.

Fshati rrencë (Banori i njëjtë) në fshatin rrenc ka mbaruar investimi dhe është e nevojshme pastrimi I kanalit është tërësisht e bëshme.

### **5.Rrjeti Rrugor**

**Xhavit Lohja** banorë i fshatit Grenas – është mirë që është edhe sekretari i këshillit bashkiak dhe e di që është marrë një vendim nga këshilli bashkiak për realizimin e rrugës grenas.

Rruga Grenas është dërguar për aplikim në fondin shqiptar të zhvillimit dhe presim miratim për realizimin e kësaj rruge duke marrë parasysh që është vlerë e madhe për tu realizuar.

Fshati Rrencë – **Kole Marku** – nga rruga rrenc bardhaj është përfunduar në qendër të fshatit rrencë rruga për tek kisha – Rruga Coklaj.

**Isak Bajrami** banorë fshati Vukatan – kemi propozu edhe vjet rrugën që bashkon qendrën shëndetsore me kodren (koder vukatan) janë shumë sera dhe bujq që e kalojnë këtë rrugë.

Në juban duhet edhe rruga nga qendra tek kodra e ferracakve.

Ndrek Gega- Fshati Juban – ka një kishë dhe të gjithë njerëzit që e frekuentojnë e kanë shumë të vështirë për ta aksesuar

Ka nevojë për trotuar gjithashtu sepse janë femijët dhe të gjithë që e kalojnë dhe është shumë e rezikshme.

Të vendosen edhe bume për parandalimin e shpejtesisë

Kërkojmë edhe ndryshim të emërimit të rrugës së Jubanit.

Rrugët e brendshme të fshatit Juban që lidh të gjitha rrugët duhet të rikualifikohet.

**Pjerin Marku** – Rrugët e brendshme të fshatit Juban janë ba disa dhe ka përfunduar loti I parë i rrugës së rragamejve dhe do të vijojë loti I II etj. Jubani është fshat i shtrirë dhe ka nevojë për shumë investime

Trotuari është shumë i rëndësishëm.

**Ridvan Guri** – të gjitha këto rrugë janë propozuar dhe janë në listën e rrugëve prioritare për zbatim për njësinë administrative Guri i Zi. Prioriteti kryesor ka qënë në vite rruga e Grenasit por për efekt financimi ka normalisht nevoja për tu realizuar.

Rruga e Rragamit kemi bërë ndërhyrje në pastrim te kanalit a është mundur që të ketë një punëtorë që e mirëmban atë rrugë.

**Zv. kryetari** – punëtorët do të kalojnë në varësi të njësisë administrative.

Në rragam a është e mundur të futet në listë rruga në lagjen e celës.

**Pjerin Marku** – duam të realizojme shpime për burim uji privatisht - a është e mundur që përmes ujsjellsit të lidhim dhe bëjmë shpërndarjen e ujit në këto familje duke berë një kontratë energjie me OSHEE sepse ne privatisht nuk mund ta bejmë

Kemi propozuar që në disa zona janë bërë ndërhyrje privatisht dhe është e mundur që bashkia të ofrojë zhavorin dhe cimenton dhe të realizojme rrugë që janë të shkurtra me forcat tona punëtorë pra bashkia të bëjë vetëm blerjen e materialeve të ndërtimit.


**Zv. kryetari** – jemi munduar në vite së bashku me këshillin bashkiak që të zbatojmë me seriozitet propozimet e banorëve. Së fundi falenderoj pjesëmarrësit për prezenzen dhe propozimet.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

**Mbajtësi i Procesverbalit:**

**Bekim Mema**






BASHKIA  
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.

Nj.Administrative Guri I Zi

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Abazit Jahid	Jahid	Mashkull	78	Kuc	Sen gjornist	—
2	Arpa Petri	Petri	Mashkull	72	Preveci	Prerisicist	—
3	As-hub	Bajram	M	67	Vukstane	Bank	—
4	Edmond	Bungaj	M	36	Shkoder	Master Doctor	D.S.H.
5	Artan	Debi	M	35	Guri Zi	Administrative	D.Sh.
6	Kujtim	Jake	M	60	Kuc	kyshlyk	—
7	Feritend	Marku	M	59	Guricell	shoper	BST
8	Gjon	Ejthi	M	78	Guri Zi	Bank	—
9	Horalba	Tonq	Femer	24	Guri Zi	Specialist/Prekthi & Prekthi	Specialist/Prekthi & Prekthi
10	Denis	Lejla	M	25	Kuc	Specialist IT	—
11	Roland	Zhaka	M	32	Guri Zi		Denigjeres cifti si guri
12	Spoteh	Zej	M	40	Rruge		—
13	Thela Marku	Marku	M	50	Rruge	Kryepok	—

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA  
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.  
Nj.Administrative Guri I Zi

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
14	Zeh	Kalira	M	55	Gajton	Bujk	--
15	SAKHOT	Plucaj	M	54	Rogojan	Bujk	--
16	indok. geg		M	67	Yqubam	Pol. s. an.	--
17	Amel g	Jani	M	29	Qerri Zi	Student	
18	Miri	Fusha	M	51	KUR	Punetar	
19	Mele	Utraka	M	45	Zubon		
20	Mele	Malaci	M	32	Jubam	Shopyer M/loji	
21	Andrelim	Gjiritaj	M	--	Jubam		
22	Rishan	Burri	M	57	Jankoder	reklama	
23	Ndoc	Dimasi	M	67	Qerri Zi	qitkar	

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK